

BIBLIOTEKA

E

SHTETIT

GJIROKASTËR

**SIKA
ME YLL
NE BALLE**
roman

A stylized illustration of a woman's face in profile, looking downwards. She has long, wavy brown hair and is wearing a light-colored cap. A rifle is slung over her shoulder, with the barrel pointing upwards. The background features a pattern of dark green, leaf-like shapes. The overall style is graphic and minimalist, using brown and green tones on a light background.

**JONUZ
DINI**

DM-21
Δ52

IONUZ DINI

ÇIKA ME YLL NË BALLË

Roman

BIBLIOTEKA E DITËS
Gjithësi
66826
7661

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

LIBRI SHTETI

540
102

SIKURIA ME YLLIN E BALLE
romani

Redaktore Irena Dono
Kopertina nga Safo Marko

Tirazhi 11.000 kopje Format 78x109/32 Stash: 2204-72

Shtyp. Drejtoria Qendrore Poligrafike
Shtypshkronja «3. NËNTORI» — Tiranë, 1975

NIKË VËRRIA

«...Prindërit nuk qanë, as trarët e shtëpisë nuk qanë si qanin ngahera kur lindnin çika!» Nga përralla e gjyshes Bjeshkë.

Nga gryka e Shtojzovalleve, nga ai skutuliq i qetë shkëmbor, atje lart në atë të çarë të ashpër tërë gër-xhe e kepa të mbuluar me bimësi të rrallë, të egër, krisi një batare. Oshëtima e saj u përhap valë-valë deri poshtë në luginë, ku shtrihej i përhapur fshati Dredhëzaj. Pas pak u dëgjuan piskamat e thekshme.

— O-hoo! Ç'ka-a puuuushkaaa, moreeeee?

Një zë burri i qartë dhe i fortë jehoi nga gryka.

— Shtëpia e Nikë Vërrisë u shtua me një djalë, ohohohoo!

Pas këtyre fjalëve, nga fshati Dredhëzaj u dëgjuan një pas një krisma urimtare, të përcjella me fjalë gazmore.

— Me jetë të gjatë, moreee!

Kishte njëzet vjet që familja e Nikë Vërrisë, nuk ishte njomur nga gëzimet që sjell lindja e një fëmije, aq më shumë kur ky ishte mashkull. Miqtë u gëzuan me gjithë zemër, kurse armiqtë thanë duke qeshur me hundë:

— U shtua edhe një mish për pushkë.

Ndër ta ishte edhe familja e Dakë Ngardhës me të cilin ishin vrarë brez pas brezi. E kishte nisur gjyshi i Nikë Vërrisë, dhe i ati i kishte lënë trashëgim një

gjak borxh. Ky gjak ishte bërë shkak i hakmarrjeve të gjata, që i kishin kushtuar shtrenjt Nikë Vërrisë: vëllanë e vetëm dhe dy djem; Martinin e fejuar, në prag të martesës, ia kishte këputur pushka e Ngardharëve, ashtu si këput era nga molla dy lule të porsaçelura. Njerin, Ndoun, e kishte shtyrë vetë plaku që të vritej; sa herë e kujtonte, i therrte mu në shpirt. Dhe ja si kishte ndodhur:

Ishin gjallë të gjithë djemtë në atë kohë. Kola, më i madhi, kishte vajtur në qytet të Shkodrës një ditë të mërkurë, për të shitur dy dhi e për të blerë ca sende të nevojshme. Tata Nikë e kish porositur t'i sillte letra duhani dhe një okë barut, për një hutë të vjetër që e mbanin për gjueti. Kur vinte rasti ajo e bënte punën e vet edhe kundër ndonjë hasmi.

Nata ra, por Kola nuk u kthye me shokët e fshatit Dredhëzaj. Megjithëse Gryka e Shtojzavalleve është thellë e Konaku i Vërriajve i futur në një zgavër për t'u mbrojtur nga të papriturat, prapë nëpër dritare dhe frëngji hyjnë të gjitha lajmet e ditës. I zoti i shtëpisë u çudit fort kur pa në vend të të birit një të panjohur, që kaloi pragun me ngutje, i prishur në fytyrë:

— Në dorën tënde, i zoti i konakut! Kam vrarë një njeri në pazar të Shkodrës.

— Ulu rri si në shtëpinë tënde, o mik, e të lumtë pushka!

Pasi miku zuri vend, Nika drodhi një cigare nga kutia e vet dhe ia hodhi përpara për ta nderuar. Pas kësaj porositit të shoqen, Bjeshkën, që t'i bënte një kafe elbi të fortë.

I panjohuri, mbasi e piu kafen e thithi disa herë duhan, e mori një çikë veten dhe foli sikur po lutej për diçka:

— Unë jam prej Krasnari, i zoti i shtëpisë. Erdha te ti, jo vetëm se e ke kullën të futur në grykë, por edhe pse kam dëgjuar fjalë shumë të mira për bujarinë tënde...

— Paç faqen e bardhë ti edhe ai që ka folur mirë për mua, por unë nuk jam aspak më bujar se shokët.

— Burrëria nuk matet me kut, o Nikë Vërria, por matet me punë të urta e me mendime të mënçura.

— Ashtu drejt. Por...

Fjala iu shua ndër buzë, porsa dëgjoji andej nga kuzhina një zhurmë të mbytur, të përzishme, ndjella-keqe. U çua më këmbë.

— Më fal pak, or mik, — i tha me shumë mirë-sjellje dhe doli nga dhoma.

Atje mori vesh kobin Nikë Vërria. Kolën, djalin e madh ia kishte vrarë një prej Krasnari. Dikush e kishte parë duke iu ngjitur së përpjetës e duke u futur në grykë. Po të shpejtonin mund ta zinin pa arritur Qafën e Pishave.

— Shkoj unë, tatë, — u hodh Ndou tërë mlef.

Nikë Vërria e vërejti të birin mendueshëm.

— Jo, nuk është nevoja të kërkojmë. E kemi këtu, në dhomën e miqve.

Ndou, i ndërkyer nga dhembja e fortë që e kishte kapërthyer, u turr për atje, po i ati e ndali dhe e ktheu nga vetja me vërtik.

— Ku je ti more, mbli dhe mendjen! Si pritet miku në besë!

— Tatë!..

Plaku u kthye në dhomën e miqve. Megjithëse vdekja e djalit të madh, Kolës, ia kishte çarë zemrën më dysh, prapë ai burrë i fortë si shkëmbi kishte fuqi shpirtërore, sa të ruante të patrazuar mikpritjen shqiptare. Kuvendoi me mikun për kohën, për punët e bujqësisë, për bagëtinë. Kushedi sa do të zgjatej kjo bisedë e qetë dhe e përzemërt, sikur të mos çirrnin qetësinë e natës kujet, vigmat e klithjet e grave kur sollën në vig të vvarin.

Mysafiri u step e fytyra e tij mbeti pa gjak. Brofi në këmbë dhe ngeli për një hop si hu i ngulur në tokë. Nuk dinte ç'të bënte.

— Ç'pate, or mik? — e pyeti Nikë Vërria qetësisht.

— Unë qenkam vrasësi i tët biri, Nikë Vërria!

I zoti i shtëpisë u ngrit dhe e bindi me të butë e njerëzi, që të ulej.

— Më i sigurt se këtu nuk je askund, more krasnaras, — Pasi thithi duhan në kamish dhe mbushi bulcinjtë plot me tym, e nxori për hundësh e për goje, me shtëllunga. — Nuk ka qenë kurrë zakon të pritet miku në besë, e unë nuk e shkel këtë zakon, as nuk lë njeri ta shkelë sa të jem gjallë.

Mysafiri mezi e mori veten. Ishte një dalldisje kjo. Nuk kishte pasur rast as ta dëgjonte një gjë të tillë, as ta shihte në ëndërr, jo më ta përfytyronte veten në qendër të kësaj ndodhie.

— Gjithçka paskam dëgjuar për ty, o Nikë Vërria, nuk qenkan asgjë, para kësaj që po shoh sonte këtu. — Por befaz e humbi drejtpeshimin shpirtëror, e thirri: — O, mua m'u thaftë dora e shpirti që këputa një mollë nga dega jote...

Kërceu përprjetë, e kapi armën që ishte varur në mur, ia solli vetes, po Nikë Vërria u hodh dhe e mbajti.

— Turp të kesh, bre! Mos u bëj si grua e keqe... — U zumë për pesë para piper, e marrtë djalli pushkën e kapadaillëkun tim!

Ajo natë mezi kaloi. Dukej sikur e mbanin njerëzit e shtëpisë mbi supe me tërë peshën e saj të zezë, për ta çuar në kufijtë e agimit. Kur zbardhi drita, Nikë Vërria i tha të birit, Ndout:

— Përcille mikun deri te Ukshin Loku. Bëji të fala prej meje, e thuaj që ta çojë shëndoshë e mirë deri në Krasnar. Dëgjove? Është në besë tonë, thuaj, se ka vrrarë një njeri...

Ndou u nis bashkë me krasnarasin. Kur arritën në Qafë të Pishave, i thirri Ukshin Lokut, e i tha fjalët e tatës. Vrasësit nuk ia dha dorën, megjithëse ai ia shtriu si me frikë. Jo, ai nuk mund ta bënte këtë edhe pse i ati e bëri. Po të mos ia lidhte duart porosia e plakut, ai do t'i jepte fund qysh mbrëmë, aty, në vatër, ose kur të dilte përjashta në oborr. Tani e shihte duke kërcyer nëpër shtegun e bleruar drejt shtëpisë së Ukshin Lokut e mezi e mbante veten nga ngasja që kishte për ta lënë në vend të shpuar nga plumbat. Brenda tij u ndez një luftë e ashpër. Dhembja për vëllanë për-

leshej me kanunin dhëmbë për dhëmbë. I rrëmbyer nga gjaknxehtësia, ai ngriti pushkën dhe e ndoqi gjaksin që dukej e zhdukej atje poshtë, përmes degëzave të varura dhe të gërshetuara me gjelbërim e hije. Gishtin e kishte në këmbëz e, ja, një shtytje e vogël duhej. Po tata Nikë i doli para syve me porosinë e tij: «Mos e vraj pas shpine dhe në besë, se të vret rrufeja e mallkimit tim!»

Një muaj pasi varrosën Kolën, Nikë Vërria e thirri të birin, Ndoun, në dhomën e miqve.

— Bir, nuk të fola mbrëmë, po e lashë për tani në mëngjes, se në mëngjes shestohen punët e mira. Këtë punë do t'ia ngarkoja Martinin si radhë, po ai pas dy muajve bëhet dhëndërr si e di...

— E marr vesh për ç'ka e ke fjalën, tatë, e nuk ka më urtësisht se ç'e ke menduar ti.

Plaku thithi duhan e vërejti të birin i kënaqur. «Po, ky është tamam Vërriaj, ta kap mendimin fluturim!»

— U bë plot një muaj që vëllai yt, Kola, u mbulua në dhe. Vajti gjatë pa i marrë gjakun, po ç'të bësh. U dhashë besë një muaj, e nuk do ta shkelje besën edhe sikur të përmbyses qielli mbi ne. Në shtëpinë tonë nuk është futur kush në varr, pa i marrë gjakun, po i gjori e paska pasur këtë fat të keq...

Ndou u nis atë ditë për në Krasnar.

E pritën. Nuk u kthye. Pas tri ditësh, erdhi lajmi se gjakun e të vëllait e kishte marrë, po duke dalë nga fshati, e kishin vvarë.

Pasi varrosi edhe Ndoun, e priti miqtë e shokët për ngushëllime, Nika u nis vetë për në Krasnar. Në Qafën e Pishave, u bë me të edhe mikun e tij i ngushtë, Ukshin Loku. Një javë më vonë, u kthye gjakmarrës. Brenda pak ditësh, i ngritën këngën:

Nikë Vërria, ky burrë plak
Paska mend për një bajrak
Dhe trimni asgja ma pak
Për të birin mori gjak
Nder e nam solli n'konak!

Po ja ndodhi një e papritur tjetër që e helmoi shumë zemrën e Nikë Vërrisë. Po bëheshin përgatitjet për martesën e Martinit. Pasi pak ditësh ai do të bëhej dhëndërr. Po në njërin nga këto ditë e sollën të vrarë nga katundi Dredhëzaj. Ngardharët kishin marrë një gjak, që, gjoja, ua kishin pasur borxh Vërriajt, që në kohën e gjyshërve.

Plaku u ngrit e mori gjakun e Martinit atë ditë, pa iu ftohur ende plagët në trup. Po, ç'e do, djalin nuk mund ta kthente më në jetë. Shtëpia, që dikur gazmohej nga zërat rinore të djemve, u bë e heshtur, e zymtë, e shurdhër.

Nikë Vërria ia ngulte sytë djalit të vogël. Shpendit, «çunit të pleqërisë», siç thoshte dikur, po ky rritej ngadalë. Kurse Nika kishte ngutje të madhe, jo se vitet ishin të pabesë për të si gjaksorët, e mund ta këputnin kur s'e priste, po për më tepër nuk mund ta shihte konakun kështu të shkretuar. Frika e shuarjes së fisit, ia brente shpirtin përditë, dhe nuk i jepte asnjë çast qetësie. Nuk e lodhën mungesat e hallet e tjera, kurrë; u bënte ballë sypatrembur me bindje në forcat e vetë. Varfërisë i kishte bërë ballë gjithnjë me punë. Nuk kishte veçse një ngastër tokë, që dukej si një arnë në mes të atij shpati shkëmbor, e për çdo stinë ndërronte ngjyrë. I ati i kishte lënë vetëm shtëpinë. Një copë tokë që kishin pasur atje poshtë në luginën e fshatit Dredhëzaj e kishte shitur. Atë ngastër lart mbi shtëpi ia kishte rrëmbyer natyrës me thonj, e kjo i jepte misër për shtatë muaj, kurse bukën tjetër, që duhej deri në fund të vitit, e nxirrte nga prodhimet që i jepnin ato shtatë kokë dhi e katër kokë dele. Mushka, që kishte blerë para pesë vjetëve, përveç bradhjeve me ngarkesa të ndryshme, mbrehej edhe në vend të qeve dhe lëronin tokën me të. Kujdesi për bagëtinë nganjëherë është gati i barabartë me kujdesin për njerëzit. Kur rënkonte ndonjë dele ose ndonjë dhi, apo siç qe rasti kur mushka hëngri një bar të keq që e fryu në bark, tërë familja u bë pikë e vrer, e shqetësimi sillej nëpër shtëpi si re e zezë.

. — Bagëtia janë si gjinde, — thoshte Nikë Vërria shpesh me bindje. — Edhe ato punojnë e djersijnë për të mbajtur këtë konak më këmbë. Prandaj duhet t'i mbajmë mirë e t'i duam. . .

Kur sillte ndër mend shtëpinë e dikurshme që gu-mëzhinte si zgjoi i bletëve nga zërat rinorë të mesh-kujve truplidhur e gazmorë, plakut i hipte një mall i madh për atë kohë që nuk kthehej më kurrë. Nuk e qortonte veten. Kishte vepruar ndershmërisht dhe me drejtësi tërë jetën, e kurrë nuk e kish kërkuar be-lanë. Atë ia kishin sjellë të tjerët te dera. Të gjithë ata që i kishte ngrënë pushka i pikonin në zemër. Po go-ditjet e rënda të jetës nuk e kishin thyer dhe as për-kulur, madje e kishin bërë edhe më të fortë, mospërfil-lës për mezikun që mund t'i sillte ende e papritura tinzare. I tillë ishte Nikë Vërria. Ai ishte tamam si një shkëmb tërë thepa. Vitet e rënda që ishin përplasur mbi të me tërsëllimë e duhi tufanesh, nuk e kishin lë-muar sadopak, përkundrazi e kishin ashpërsuar edhe më shumë.

Pikërisht për pathyeshmërinë dhe mençurinë, ai gë-zonte emër të mirë në të gjithë krahinën. Bajraktari e shikonte me keqdashje pikërisht për këtë emër të mirë që kishte, e se ndonjë herë, pa dëshirën e tij, zinte vend në kuvend.

— Të thërresim edhe Nikë Vërrinë e të marrim edhe mendimin e tij, — thoshin disa kuvendtarë. — Ai e ka kokën plot dhe zemrën e artë. . .

Kur ngrihej e fliste plaku thinjosh, të gjithë ia ngulnin sytë e dëgjonin me vëmendje të madhe. Vetëm bajraktari dhe dy vojvodët e vërenin me përçmim dhe inat të dukshëm. Po Nika as kthehej ndonjëherë nga ata, sepse e dinte që aty kishte ardhur për vullnet të pleqve të krahinës.

Një herë kuvendi vendosi ashtu si tha Nikë Vërria e jo si tha bajraktari. Ky dhunim i hapur i vullnetit të prijësit kapadai tronditi edhe vojvodët, të cilët ulë-rinë si ujqrit për të vënë në vend nderin e bajrakta-rit. Po ky u bëri me dorë të heshtnin. Gjuajti me një